

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit E.D., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me plotësim kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit PN.nr.517/2018 të datës 09.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit E.D. e paraqitur kundër aktvendimit për rishikimin e procedurës penale të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.517/2018 datë 12.06.2018.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin P.nr.294/2015 e datës 27.02. 2018, e ka shpallur fajtor të dënuarin E.D. për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par 1 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumen prej 200 €, të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) muaji, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda një viti nuk kryen vepër tjetër penale. Nëse dënimi me të holla nuk mund të ekzekutohet ,gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga një ditë burgimi për 20 € të gjobës. Është obliguar i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 €.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.483/2017 e datës 09.01.2018 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktgjytimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i dënuari E.D., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë këtë kërkesë dhe aktgjykimet e lartëcekura ti ndryshoi kurse të dënuarin ta liroi nga përgjegjësia penale ose aktgjykimet ti anuloi dhe çështjen ta kthej në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës me aktvendimin PML.nr.197/2018 datë 01.10.2018 e ka hudhur si të pasafatshme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të dënuarit E.D., të paraqitur kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.294/2015 të datës 27.02.2018 dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.483/2017 të datës 09.01.2018.

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.365/2018 datë 13.04.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e të dënuarit E.D., për Rishikimin e Procedurës Penale, e ushtruar kundër aktgjyimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë P.nr.294/2015 datë 27.02.2017, dhe aktgjyimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.483/2017 datë 09.01.2018.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.nr.517/2018 datë 12.06.2018 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të dënuarit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë KP.nr.365/2018 të datës 13.04.2018.

Kundër aktvendimit për rishikimin e procedurës penale të Gjykatës së Apelit PN.nr.517/2018 të datës 12.06.2018, i dënuari ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të KPPK si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës kërkesën ta aprovoj si të bazuar.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.140/2018 e datës 16.08.2018, ka propozuar që plotësim kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dënuarit e ushtruar kundër aktvendimit për rishikimin e procedurës penale të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.517/2018 e datës 12.06.2018 të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435 par.1 dhe par.2 të KPPK, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e të dënuarit janë të pabazuara, meqë aktvendimi kundër të cilit është parashtruar kërkesa, nuk përmban shkelje të ligjit penal e as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat pretendohen.

Në këtë çështje penalo juridike, dispozitivi i aktvendimit të kundërshtuar është i qartë, konkret, i njëjti nuk përmban kundërthënie me vet veten e as me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktvendimit të shkallës së parë janë dhënë mjaftë arsye për refuzimin e kërkesës e të cilat arsye i ka aprovuar edhe Gjykata e Apelit, ashtu që provat e ofruara nga i dënuari kanë qenë edhe më parë objekt shqyrtimi gjatë procedurës së më hershme e të cilat janë vlerësuar, andaj sipas

vlerësimi të kësaj gjykate, në kërkesën e parashtruar nga i dënuari për rishikimin e procedurës penale, nuk është prezentuar ndonjë fakt apo provë e re , e cila ka qenë e panjohur për gjykatën në momentin e marrjes së aktgjykimeve të lartpërmendura, e cila vet apo së bashku me provat e tjera të mëparshme do ta arsyetonte pafajësinë e të dënuarit, në këtë mënyrë provat e propozuara nuk mund të paraqiten si arsye për rishikimin e procedurës në kuptim të nenit 423 par 1 dhe 2 të KPPK.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 435 par.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Më 16.10. 2018, Pml.nr.261/2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,
Emine Mustafa